



# SI MUND T'I MBROJ TË DREJTAT E MIA NËPËRMJET INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS?

Kosova ka institucione të mandatuara për t'i mbrojtur të drejtat tuaja pronësore.

Aktualisht, organet kryesore kompetente për t'i gjykuar ankesat e parashtruara për pronën e paluajtshme private janë **Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe Gjykatat e Kosovës.**

Fushatë vetëdijesimi mbi mjetet ligjore lidhur me pronën  
tetor - nëntor 2007

# I. KËRKESAT PRONËSORE QË LIDHEN ME KONFLIKTIN

**Agjencia Kosovare e Pronës (AKP)** është themeluar më 4 mars të vitit 2006, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. AKP-ja është agjenci e pavarur administrative që ka kompetenca për të pranuar, regjistruar dhe zgjidhur kërkesat përkitazi me pronën e paluajtshme private që lidhet me konfliktin, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

AKP-ja gjithashtu ka trashëguar të gjitha përgjegjësitë e ish-**Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore – Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (DÇPB/KKPB)**. Kështu, AKP-ja do t'i implementojë të gjitha kërkesat për pronë banesore që janë në pritje pranë DÇPB-së që nga 4 marsi i vitit 2006.

## 1. KËRKESAT MBI PRONËSINË DHE/OSE TË DREJTAT E SHFRYTËZUESIT

### ÇKA MUND TË BËJ NËSE E KAM HUMBUR PRONËN SI REZULTAT I KONFLIKTIT?

Kërkesat që kanë të bëjnë me konfliktin janë përkufizuar si kërkesa që përfshijnë rrethanat që lidhen drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur ose që rezultojnë nga ky konflikt që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Ju mund të parashtroni një kërkesë që lidhet me konfliktin kur për shembull:

- Prona ka qenë ose është e uzurpuar si rezultat i zhvendosjes së pronarit;
- Ka pasur ose ka ndërtim të paligjshëm në tokën bujqësore në të cilën nuk ka pasur qasje pronari legjitim i zhvendosur;
- Ka pasur ose ka uzurpim të paligjshëm të banesës ose biznesit.

AKP-ja është kompetente për t'i zgjidhur të gjitha kërkesat që lidhen me konfliktin që përfshinë **pronën private ose të drejtat për shfrytëzim të pronës**, kur parashtruesi i kërkesës nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta.

AKP-ja është kompetente për t'i zgjidhur të gjitha kërkesat mbi pronat private që lidhen me konfliktin përfshirë:

- Kërkesat për pronën private banesore që tanimë nuk kanë qenë të shqyrtuara dhe të gjykuara nën mandatin e DÇPB-së/KKPB-së;
- Kërkesat për pronën private bujqësore dhe komerciale.

AKP-ja **nuk është kompetente** për t'i zgjidhur kërkesat që kanë të bëjnë me:

- Humbjen e pronës ose posedimit të saj që nuk rezulton nga konflikti (siç është nacionalizimi nga autoritetet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë);
- Kompensimin e dëmeve të pësuar gjatë ose pas konfliktit dhe që janë parashtruar kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe/ose Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes duke përfshirë kërkesat në lidhje me shtëpitë e shkatërruara ose të dëmtuara gjatë trazirave të marsit të vitit 2004.

Po ashtu, AKP-ja **nuk është kompetente** për të:

- Ofruar ndihmë për rindërtimin e shtëpisë suaj nëse ajo është shkatërruar.

◇ Kush mund të parashtojë kërkesë pranë AKP-së?

Çdo person fizik ose juridik, në mënyrë individuale ose përmes përfaqësuesit ligjor që ka prokurë të vlefshme mund të parashtrorë kërkesë në Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së.

Ju mund të parashtroshi një kërkesë dhe mund të veproni në emër të anëtarëve të familjes në vijim, kur ai person nuk ka mundësi të parashtrojë ankesë, siç janë bashkëshortja, fëmija (i lindur në kurorë ose jashtë kurorës ose i adoptuar), fëmija i njërit bashkëshort dhe nipërit/mbesat pa prindër, prindërit (babai dhe nëna, njerku, njerka, dhe adoptuesi), si dhe çdo person tjetër të cilin jeni të obliguar ta përkrahni sipas ligjit.

◇ Ku mund ta parashtrojë kërkesën?

Ju mund ta parashtroshi kërkesën tuaj në AKP në cilëndo nga zyrat e AKP-së në Kosovë, si më poshtë:

### **SELINË QENDRORE TË AKP-SË**

mailbox@kpaonline.org

Nazim Gafurri 31, Prishtinë/Priština

Telefoni: +381 (0)38 249-918

Telefaksi: +381 (0)38 249 919

### **AKP-ja në Prishtinë/Priština**

Rr. Rexhep Luci 2/Goleska Rr.2

Telefoni: +381 (0)38 225 473

Telefaksi: +381 (0)38 244 854

### **AKP-ja në Gračanica/Gračanicë**

Përballë ndërtesës së Kuvendit Komunal

### **AKP-ja Gjilan/Gnjilane**

Rr. Rade Popovic

Telefoni: +381 (0)280 320 289

Telefaksi: +381 (0)280 324 067

### **AKP-ja në Mitrovicë/Mitrovica**

Zyra kryesore:

Selia Qendrore Rajonale e UNMIK-ut (Jugobanka)

Telefoni: +381 (0)28 530 136/7

Telefaksi: +381 (0)28 530 139

Zyrat për vizitorë:

Jug: Rr. Mbretëresha Teutë (përballë Jugobankës)

Veri: Ndërtesa e AKM-së, zyra nr. 18, kompleksi i stacionit të UNMIK-ut në Veri

### **AKP-ja në Pejë/ Peć**

Zyra kryesore:

Rr. "Mbretëresha Teuta" 85

Telefoni: +381 (0)39 431 668

Telefaksi: +381 (0)39 432 970

### **AKP-ja në Prizren**

Zyra kryesore:

Selia Qendrore Rajonale e UNMIK-ut

Tel/Faks: +381 (0) 29 631-469

Tel: (038) 504604 lok. 8046/8024

Zyra e vizitorëve:

Rruga Jeronim De Rada"/ "Zef Llush Marku"/ "Metohijska" nr. 63

Tel: +381 (0)29 631-429

Gjithashtu, mund të thirrni në linjën kujdestare të AKP-së në 038 249 936 për të kontaktuar me zyrat e AKP-së.

◇ A duhet të paguaj për fillimin e procedurës në AKP?

Procedura është falas.

◇ Ku mund ta parashtrijë ankesën nëse aktualisht jam i zhvendosur jashtë Kosovës?

Ju mund ta parashtroni kërkesën tuaj pranë AKP-së, në cilëndo zyre në Serbi, Mal të Zi dhe në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), si më poshtë:

## **NË SERBI:**

### **AKP-ja në Beograd**

Kosovska 49/8

Telefoni: + 381 (0)11 334 5513

Telefaks: + 381 (0)11 334 5314 | 011/334-4452

### **AKP-ja në Kragujevc**

9, Rr. "Lole Ribara", kati i tretë

Telefoni: + 381 (0)34 330-234; 330-784

### **AKP-ja në Kraljevi**

Cara Dusana 21

Telefoni: + 381 (0)36 234-781

### **AKP-ja në Nish**

Rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova),

Kati i tretë, zyra nr. 308

Telefoni: + 381 (0)18 515-727; 515-728

## **MALI I ZI:**

### **AKP-ja në Podgoricë**

Crnogorskih Serdara

Telefoni: + 382 (0)81 624 216 / (0)81 623-744

## **IRJM:**

### **AKP-ja në Shkup**

Rr. Vinichka nr. 10 (Ndërtesa e CDRIM-së), kati i parë

Telefoni/Cel: +389 (0)71 886 564

Përveç kësaj, disa ekupe lëvizëse veprojnë në Serbi dhe në Mal të Zi. Ju mund të thërrisni zyrën e AKP-së në Beograd +381 (0) 11 334 5513 për të marrë informata për zyrat e AKP-së dhe për ekipet lëvizëse në territorin e Serbisë dhe të Malit të Zi.

Po ashtu, në faqen e internetit të AKP-së: [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org) mund të merrni më shumë informata mbi parashtrimin e kërkesës në AKP, për mandatin e saj si dhe për ligjin në fuqi për procedimin dhe zgjidhjen e kërkesave.

◇ Çka ndodhë me kërkesën time pasi ajo të pranohet nga AKP-ja?

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së do ta **pranojë, regjistrojë dhe do të njoftojë për kërkesën** dhe do t'ia dërgojë një kopje të saj personave që mund të kenë interes juridik në atë pronë.

Në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kopjes së kërkesës, personi pranues mund t'ia dorëzojë Sekretarisë Ekzekutive një përgjigje ndaj kërkesës.

◇ Kush do ta shqyrtojë kërkesën time?

**Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP)** është organi kompetent në kuadër të AKP-së.

KKP-ja, ose do ta hedhë poshtë kërkesën tuaj, ose do ta pranojë ose do ta refuzojë atë.

Nëse kërkesa juaj bie jashtë shtrirjes së juridiksionit të AKP-së, ose ju nuk e parashtroi kërkesën e kompletuar, KKP-ja mund ta hedhë poshtë atë.

Nëse kërkesa juaj është brenda juridiksionit të AKP-së dhe është e kompletuar, KKP-ja do ta hetojë rastin tuaj dhe do t'i verifikojë dokumentet e parashtuara në përkrahje të kërkesës.

KKP-ja do të marrë vendim juridikisht detyrues që e konfirmon, ose e refuzon kërkesën tuaj.

◇ A mund të parashtrojë ankesë ndaj vendimit të KKP-së?

Po, ju mund të parashtroi ankesë kundër vendimit të KKP-së pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Ankesa mund të parashtrohet ndaj çdo vendimi të KKP-së, përfshirë edhe hedhjen poshtë të kërkesës.

◇ Si do ta di për vendimin e KKP-së?

Sekretaria Ekzekutive do t'ju njoftojë për vendimin e KKP-së.

◇ Pas sa ditësh kam të drejtë për t'u ankuar ndaj vendimit?

Ju, apo pala tjetër mund ta parashtroi ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditësh që nga njoftimi juaj nga AKP-ja për vendimin e KKP-së.

◇ Çka do të bëj nëse dëshiroj të parashtrojë ankesë?

**Pas kërkesës**, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së do t'ju ofrojë informata dhe udhëzime për procedurat që duhet të përcillen për ta përgatitur ankesën.

Brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i kopjes së ankesës, pala tjetër do t'ia dorëzojë përgjigjen me shkrim Gjykatës Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë së AKP-së.

◇ Kush do ta vlerësojë ankesën time në Gjykatën Supreme?

Gjykata Supreme e Kosovës do të vendosë për ankesat përmes një paneli të përbërë nga tre (3) gjyqtarë, dy prej të cilëve do të jenë ndërkombëtarë.

◇ Cilat janë kompetencat e Gjykatës Supreme?

Gjykata Supreme ka kompetenca për t'i kërkuar KKP-së sqarime shtesë për vendimin.

Gjykata Supreme mund të shqyrtojë **fakte dhe dëshmi të reja** nëse vërtetohet se pala në kohën kur është parashtuar kërkesa nuk ka mundur t'i dijë me arsye faktet dhe dëshmitë.

AKP-ja, nëpërmjet Sekretarisë Ekzekutive do t'ju njoftojë palët mbi vendimin për ankesën.

◇ A mund të parashtrojë ankesë ndaj vendimit të marrë nga Gjykata Supreme?

Vendimet e Gjykatës Supreme janë përfundimtare dhe të plotfuqishme dhe nuk mund të sfidohen.

◇ A mund ta posedojë sërish pronën time menjëherë pasi të miratohet vendimi i KKP-së?

Nëse nuk është bërë asnjë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, vendimi i KKP-së bëhet i ekzekutueshëm brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e njoftimit të palëve për vendimin.

Në rast të ankimit ndaj vendimit të KKP-së, vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës gjithashtu do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e njoftimit të palëve për vendimin. Vendimi i Gjykatës Supreme **e vërteton titullin e pronës.**

Vendimi mund të hyjë në fuqi përmes mekanizmave të ndryshëm që përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- dëbim;
- vendosjen e pronës nën administrim;
- marrëveshje për qiradhënie;
- konfiskim;
- rrënim të strukturave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, dhe
- ankand.

◇ A mund të parashtrijë ankesë ndaj vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore (KKPB) nëpërmjet KKP-së?

Po, por pas rishqyrtimit nga ana e KKPB-së, vendimi është përfundimtar.

◇ A mund ta regjistrojë titullin pasi të jetë konfirmuar nga KKP-ja?

Po, ju mund ta regjistroni titullin tuaj të konfirmuar në Regjistrin për Drejtat mbi Pronën e Paluajshme të Kosovës.

**Për informata dhe udhëzime shtesë, vizitoni faqen e internetit të AKP-së: [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)**

## **2. SKEMA E QIRADHËNIES E AKP-SË**

### **SI MUND TA MARR QIRANË NËSE PRONA IME ADMINISTRUOHET NGA AKP-JA?**

AKP-ja ka autorizime për të administruar pronat e banimit ose me kërkesë të poseduesve të së drejtës pronësore/të shfrytëzimit që janë të zhvendosur, ose me iniciativën e vet për ato prona për të cilat poseduesit e ligjshëm të së drejtës pronësore nuk anë identifikuar, ose nuk mund të vëhen kontaktet me ta. Në shtator të vitit 2006, AKP-ja ka nisur së zbatuari **SKEMËN E QIRADHËNIES.**

Me kërkesë eksplicite të pronarit - në rastet kur është e zbatueshme - AKP-ja autorizohet për të kërkuar pagesën e qirasë nga shfrytëzuesi(t). Nëse shfrytëzuesi(t) pajtohet(en), AKP-ja mbledhë qiranë dhe ia dërgon poseduesit të së drejtës në pronë i cili është i zhvendosur. Në rast se shfrytëzuesi refuzon ta paguaj qiranë, lëshohet urdhri për dëbim dhe zbatohet brenda 30 ditësh.

**Të gjithë poseduesit e të drejtës pronësore të cilët janë të zhvendosur, prona e të cilëve është nën administrim të AKP-së, mund të bëjnë kërkesë që të jenë pjesë e SKEMËS SË QIRADHËNIES.**

Nëse e keni ndërruar adresën, ju gjithashtu mund të kërkonti informata për statusin e pronës suaj dhe të kërkonti që t'i bashkoheni skemës së qiradhënies.

Vëni kontakte me cilëndo zyre të AKP-së ose vizitoni faqen e internetit: [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)

## **II. NDIHMA NË RINDËRTIM**

### **ÇKA MUND TË BËJ NËSE JAM I ZHVENDOSUR DHE KAM NEVOJË PËR BANESË DHE/OSE PËR NDIHMË NË RINDËRTIM?**

Grupet punuese komunale për kthim janë përgjegjëse për koordinimin e zhvillimit dhe implementimin e projekteve që iu sigurojnë personave të zhvendosur banim dhe/ose ndihmë për rindërtim, si dhe

shërbime tjera (në punësim, shëndetësi, arsim).

Nëse jeni të zhvendosur dhe keni nevojë për banim dhe/ose ndihmë në rindërtim, ju duhet të kontaktoni me Zyrтарin komunal për kthim në komunën tuaj të prejardhjes.

### III. KËRKESAT PRONËSORE QË NUK LIDHEN ME KONFLIKTIN

Në parim, të gjitha kërkesat civile pronësore **që nuk janë rezultat i konfliktit**, siç janë, por nuk kufizohen në: kontestet që kanë të bëjnë me shitblerjet pas konfliktit dhe mospagesa e qirasë, paraqiten në Gjykatat Komunale të Kosovës.

Ndaj të gjitha vendimeve të Gjykatave Komunale që kanë të bëjnë me kontestet pronësore mund të parashtrohet ankesa:

- Në shkallën e dytë në Gjykatën e Qarkut, dhe
- Në shkallën e tretë në Gjykatën e Supreme.

Ju këshillojmë se nëse keni ndonjë kontest që ka të bëjë me pronën dhe dëshironi ta ngrini para ndonjë Gjykate të Kosovës, sipas ligjit parashihen afate përfundimtare të rrepta.

#### **ÇKA MUND TË BËJ NËSE PRONA IME BANESORE ËSHTË UZURPUAR PËRSËRI APO ËSHTË DËMTUAR?**

Nëse të drejtat tuaja tanimë **janë vërtetuar** nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore ose ndonjë gjykatë kompetente dhe uzurpuesi i paligjshëm është dëbuar, por pas dëbimit ai apo dikush tjetër ka uzurpuar sërish pronën tuaj, Shërbimi Policor i Kosovës do ta dëbojë sërish uzurpuesin e paligjshëm (nuk ka nevojë për urdhër të ri dëbimi). Në raste të tilla, kërkoni këshillë nga ndonjë jurist apo kontaktoni me zyrën ndërlidhëse të gjykatës.

Hyrja në pronën e dikujt tjetër dhe/ose uzurpimi i pronës pa pëlqimin e pronarit është vepër penale. Ju keni të drejtë të paraqitni një ankesë për vepër penale në Shërbimin Policor të Kosovës apo drejtpërdrejt në zyrën e prokurorit komunal (Zyrat e prokurorëve komunal ndodhen në ndërtesat e gjykatave komunale). Ky veprim mund të bazohet në uzurpimin e pohuar të paligjshëm dhe/ose hyrjen e paligjshme apo dëmtimin e pronës suaj. Policia dhe prokurorët do të zhvillojnë hetime dhe do të veprojnë në mënyrë të duhur.

#### **Zyrat ndërlidhëse në gjykata**

Ju mund të parashtroni kërkesën tuaj përmes zyrave ndërlidhëse në gjykata (ZNGj), në vendbanimet vijuese:

Gračanica/Gračanicë, Novobërdë/Novo Brdo, Goraždevac/Gorazhdevc, Vrbovac/ Vërbovc, Velika Hoča/Hoçë e Madhe, Priluzje/Priluzhë, Silovo/Shillovë, Mitrovicë/Mitrovica, Novak/Novake, Babljak/Bablak. Personeli i ZNGj-së në Goraždevac/Gorazhdevc i shtrinë shërbimet e veta edhe në Osojane/Osojan, ku shkojnë çdo të mërkurë nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Zyrat ndërlidhëse në gjykata u ofrojnë komuniteteve shërbime si në vijim:

- Transportimin e palëve për të marrë pjesë në seanca gjyqësore;
- Ndihmë për parashtrimin e padive civile apo penale;
- Ndihmë rreth gjetjes së padive të vjetra në arkivat e gjykatës;
- Sigurim të informatave ligjore mbi çështjet që prekin refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit;
- Lehtësim në vërtetimin e kontratave;

- Referim dhe ndërlidhje me organizata joqeveritare dhe përkrahje të përgjithshme gjatë proceseve gjyqësore.

## Shih informatat për kontaktim në Shtojën 1

Ju gjithashtu mund të kërkonti këshilla nga OJQ-të siç janë PRAXIS, PRAVNI CENTAR (QENDRA JURIDIKE), Projekti i të Drejtave Civile/Kosovë (CRP/K) apo Lëvizja për Paqe – [Movimiento por la Paz (MPDL)], të cilat ofrojnë ndihmë ligjore pa pagesë. Informatat për kontaktim:

### Praxis Belgrade

Alekse Nenadovica 7  
Tel: + 381 (0)11 3444486,  
+ 381 (0)11 3444496  
Fax: + 381 (0)11 3444483

### Praxis Kraljevo

Heroja Maricica 70  
Tel: + 381 (0)36-312658  
+ 381 (0)36 312659  
E-mail: kvoffice@praxis.org.yu

### Pravni Centar Podgorica

Podgoricë  
Rr."13 jul" nr.7  
Tel. +382 (0)81/237-952  
+382/69388237

### CRP/K Prishtinë/Pristina HQ

"Bell Popova" Rr. # 10  
Qyteza Pejton  
Tel/fax: + 381 (0)38 243 610/611

### Nën-zyra në Graçanicë/

#### Gracanica

Ndërtesa e Mercy Corps  
E-mail: crp.pr@crpkosovo.org

### CRP/K Prizren

"Jeronim De Rada" Rr. # 63  
Tel. + 381(0)29 622 552  
E-mail: crp.pz@crpkosovo.org.

### CRP/K Peja/Peç

"Nëna Terezë" Rr. # 31  
Tel/fax: + 381 (0)39 32 669  
E-mail: crp.pe@crpkosovo.org

### CRP/K Mitrovicë/Mitrovica

"Kemajl Ataturk" Rr # 31-32  
Tel: +381 (0)28 39 458  
E-mail: crp.mi@crpkosovo.org

### Nën-zyra në Zveçan:

"Kralj Petar Prvi", Ndërtesa  
UNHCR

### CRP/K Gjilan/Gnjilane

Lidhja e Prizrenit Rr. # 32  
Tel/fax: +381 (0)38 280 25 500  
E-mail: crp.gl@crpkosovo.org

### MPDL

Kryesuesi i Zyrës  
Rr. Luan Haradinaj 9-A-1  
Tel/Fax: +381 (0) 38 228 372  
Cel. +377 44 421 147  
E-mail: pristina@mpdl-balkan.org  
legal.pristina@mpdl-balkan.org

### MPDL Montenegro - Podgorica

Kryesuesi i Zyrës  
Cel. 381 (0) 69 316 641  
E-mail:  
podgorica@mpdl-balkan.org

### Ekipi Ligjor Podgorica

Tel/fax: 381 (0) 81 634 846  
E-mail:  
legal.podgorica@mpdl-balkan.org

### MPDL Serbi - Zyra në Beograd

Cel. 381 (0) 63 442 555  
E-mail:  
belgrade@mpdl-balkan.org  
nis@mpdl-balkan.org

### Ekipi Ligjor Beograd

Tel :381 (0) 11 324 1188  
E-mail:  
legal.nis@mpdl-balkan.org

### Ekipi Ligjor Nish

Tel: 381 (0) 18 254 995  
E-mail:  
legal.nis@mpdl-balkan.org

## IV. KËRKESAT KUNDËR SHPRONËSIMEVE TË MUNDSHME TË PARREGULLTA

### ÇFARË MUND TË BËJ NËSE KOMUNA OSE NDOJË ORGAN TJETËR PUBLIK MË KA SHPRONËSUAR NGA PRONA IME DHE UNË NUK PAJTOHEM ME KUSHTET E KOMPENSIMIT?

Shpronësimi nënkupton se autoritetet publike ju kanë privuar nga e drejta për të poseduar ose për të shfrytëzuar pronën tuaj dhe kanë vendosur që të ndryshojnë destinimin e saj për qëllime të publikut



(ndërtimi i objekteve publike, infrastrukturës, etj.)

Nëse jeni shpronësuar nga prona juaj, ju keni të drejtë në kompensim në çfarëdo rasti – autoritetet komunale janë të obliguara të ju kompensojnë.

Nëse jeni në Kosovë dhe jeni informuar nga autoritetet komunale se prona juaj i nënshtrohet vendimit për shpronësim:

- Ju keni të drejtë të parashtroni **ankesë** kundër vendimit para Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës;
- Ju keni të drejtë të **diskutoni për kompensimin** me autoritetet komunale. Një kompensim i tillë do të kalkulohet në bazë të vlerës së tregut të pasurive të paluajtshme.
- Në rast të mosmarrëveshjes për shumën e kompensimit ndërmjet komunës dhe juve, **Gjykata Komunale** është ajo që vendosë.

2. Nëse nuk keni qenë në gjendje të dini për situatën, për shkak të zhvendosjes suaj apo për çfarëdo arsye tjetër dhe keni kuptuar se prona juaj i është nënshtruar vendimit për shpronësim – ju gjithashtu keni të drejtë për kompensim të duhur. Ju duhet të:

- Kontaktoni me Zyrën Komunale për Komunitete, në komunën ku gjendet prona juaj. Kjo zyrë do të duhej të konfirmojë shpronësimin dhe të ju informojë lidhur me punët që zhvillohen në pronë;
- Kontaktoni komunën për të kuptuar se në cilën fazë ndodhet procedura e shpronësimin;
- Nëse ju është caktuar një përfaqësues i përkohshëm nga komuna, kontaktoni atë për të kuptuar se a është miratuar ndonjë vendim që prek pronën tuaj. Nëse komuna nuk ka caktuar përfaqësues të përkohshëm për ju, kontaktoni autoritetet lokale.

Sidoqoftë, ju keni tridhjetë ditë për të parashtruar ankesë kundër vendimit për shpronësim nga momenti kur kuptoni për shpronësimin. Mos humbni kohë. Nëse pajtoheni me vendimin, kërkonte kompensim të duhur.

***Ju gjithashtu mund të kërkonte këshilla nga OJQ-të siç janë PRAXIS, PRAVNI CENTAR (QENDRA JURIDIKE), Projekti i të Drejtave Civile/Kosovë (CRP/K) apo Lëvizja për Paqe-[Movimiento por la Paz (MPDL)], të cilat ofrojnë ndihmë ligjore pa pagesë. Informatat për kontaktim janë të paraqitura më lart.***

Nëse përndryshe dëshironi t'i vërtetoni të drejtat e pronësisë apo të shfrytëzimit të pronës, të cilat nuk mund t'i gëzoni si rezultat i konfliktit, ju mund të parashtroni kërkesë përmes AKP-së (**Shih: 1. Kërkesat mbi pronësinë dhe/ose të drejtat e shfrytëzuesit**)

## **V. ÇKA MUND TË BËJ NËSE DIKUSH I KA FALSIFIKUAR DOKUMENTET PËR TË SHFRYTËZUAR/SHITUR PRONËN TIME**

Falsifikimi i dokumenteve dhe mashtrimi janë vepra penale. Ju duhet të parashtroni ankesë para prokurorit publik komunal në komunën ku gjendet prona juaj. Po ashtu, ju mund të paraqitni një kërkesë për ndjekje penale para prokurorit publik komunal në komunën ku ka ndodhur falsifikimi, nëse është tjetër nga ajo ku gjendet prona juaj.

**Në Shtojcën 1, shih informatat për kontaktim me Zyrat e ndërlidhjes me gjykatat brenda Kosovës.**

## VI. KËRKESAT KUNDËR PËRJASHTIMIT NGA PËRFITIMET E PRIVATIZIMIT

**ÇKA NDODH NËSE JAM PËRJASHTUAR NGA LISTA E PUNËTORËVE, TË CILËT KANË TË DREJTË PËR TË PËRFITUAR NGA NDARJA E TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI?**

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, punëtorët e ish-ndërmarrjeve shoqërore (NSh) kanë të drejtë, në bazë të prioritetit të dhënë, të marrin 20% nga të ardhurat e shitjes së aksioneve nga privatizimi i këtyre ndërmarrjeve. Punëtorët do të regjistrohen në **listën e punëtorëve me të drejtë përfitimi**. Megjithatë, nëse nuk jeni përfshirë në listë:

- Ju mund të parashtroni ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për mospërfshirje në listën e punëtorëve me të drejtë përfitimi, brenda njëzet (20) ditëve pas publikimit përfundimtar në media të listës së punëtorëve me të drejtë përfitimi;
- Nëse keni punuar në NSh para vitit 1999, por për arsye të **praktikave diskriminuuese** nuk jeni më punëtor gjatë kohës së privatizimit, ankesa e juaj mund të bazohet në praktika diskriminuuese. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit do të duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim.

Si praktikë e vazhdueshme e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ankesat kundër përjashtimit nga lista e punëtorëve me të drejtë përfitimi mund të parashtrohen edhe para Zyrës së UNMIK-ut/BE-së në Beograd (data relevante e parashtrimit konsiderohet data e parashtrimit në Beograd), në adresën vijuese:

### **ZYRA E SHTYLLËS SË BE-së NË BEOGRAD**

Tolstojeva nr. 47-49  
11000 Beograd, Serbi  
TEL: + 381 11 367 4003 or  
+ 381 11 367 4006  
FAX: + 381 11 367 4001

Për informata të mëtejme, ju mund të kontaktoni me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-së, në adresën vijuese:

Prishtinë/Priština  
Rr "Radovan Zogovic" nr.5  
Qyteza Pejton,  
TEL: + 381 (0) 38 200 180 48

***Ju gjithashtu mund të kërkoni këshilla nga OJQ-të siç janë PRAXIS, PRAVNI CENTAR (QENDRA JURIDIKE), Projekti i të Drejtave Civile/Kosovë (CRP/K) apo Lëvizja për Paqe - [Movimiento por la Paz (MPDL)] , të cilat ofrojnë ndihmë ligjore pa pagesë. Informatat për kontaktim janë të paraqitura më lart.***

**Shtojca 1: Informatat për kontaktim të zyrtarëve ndërlidhës në gjykatë**

<b>Seksioni për Integrim Gjyqësor (SIGj) Gračanica/Gračanice, Zyra e Ndërlidhjes në Gjykatë (ZNGj)</b>			
Trifun	Jovanovic	Zyrtar Kryesor i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 310-807 063 732-8055
Tamara	Nicic	Asistente Administrative	038 64 248
Sonja	Jokic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	063 848-6362 044 402-132
Ivan	Subaric	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-641
Boban	Živic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	063 884-1149 044 402-133
<b>SIGj Goraždevac/Gorazhdevc, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Gorica	Dakic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	063 821-2855
Slavko	Dakic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-635
<b>SIGj Mitrovicë/Mitrovica, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Bojana	Bojovic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	063 850-9507
Nysret	Hoxha	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	
Tijana	Simic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	063 787-4689
<b>SIGj Novobërdë/Novo Brdo, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Boban	Stankovic	Zyrtar për Çështje të Minoriteteve	044 163-717
Zoran	Sumakovic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 408-224
Dragan	Vasic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	063 821-2634 044 418-645
<b>SIGj Priluzje/Priluzhë, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Slavisa	Jovanovic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	064 127-3688
Tanja	Vasic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	044 425-648
<b>SIGj Silovo/Shillovë, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Bojan	Petrovic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	063 732-4066
Slavica	Trajkovic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	063 742-2644
<b>SIGj Velika Hoča/Hoçë e Madhe, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Darko	Antic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-643 029 77879
Katarina	Mikic	Zyrtare e Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-644 029 77879
<b>SIGj Vrbovac/Vërbovc, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Vladan	Stoimenkovic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-642
Aleksandar	Stoiljkovic	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	044 418-638
<b>SIGj Novak/Novake, Nën-zyra e ZNGj-së</b>			
Nikolic	Bogoljub	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	
Karandza	Rashet	Zyrtar i Ndërlidhjes në Gjykatë	

